



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1044/27 Prot.

Fier, më 13.10. 2021

Lënda: Njoftim për Thirrje të veçantë 10

ZYRES VENDORE TE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PËRMET-KËLCYRE

Për dijeni: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR


TIRANË

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Thirrjen e veçantë 10 “e vendeve të lira me afat të caktuar për punonjës të njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet publike të arsimit parauniversitar (IPAP) në ZVAP në varësi të DRAP Fier”, për të cilin keni detyrim ta publikoni në faqen zyrtare të institucionit tuaj si dhe në këndin e njoftimeve.

Duke ju falenderuar,

DREJTORI

BRUNILDA DHAMO





MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1044/2 Prot.

Fier, më 13.10. 2021

THIRRJE E VECANTË 10

E VENDEVE TË LIRA ME AFAT TË CAKTUAR PËR PUNONJËS TË NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP) NË ZVAP NË VARËSI TË DRAP FIER

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “i ndryshuar, VKM nr.99 datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njesisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social” , si dhe bazuar në kërkesën e ZVAP Përmet-Këlcyrë datë 04.10.2021, shpall vendin e lirë të punës me afat të caktuar, për punonjës të shërbimit psiko-social si më poshtë:

1. ZVAP Përmet-Këlcyrë në:

Gjimnazin “Sejfulla Maleshova” dhe mbulon shkollat:

Gjimnazin “Sejfulla Maleshova”

Shkollën 9-vjecare “Kamber Bënja”

Kriteret për t’u punësuar në shërbimin psikosocial

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim janë:

1. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të parë, në fushën përkatëse (nëse ka të përfunduar edhe ciklin e dytë përbën avantazh për kandidatin)
2. Njohuri bazë në kompjuter;
3. Aftësi komunikuese dhe të punës në grup.

I. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);
4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës Bachelor , vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta të ciklit të parë Bachelor (e detyrueshme);
8. Listë notash e noterizuar e ciklit master (nëse ka master).
9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë);
10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave .
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
12. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (detyrueshme).

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier brenda afatit 13.10.2021- 15.10.2021.

II. Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhet nga komisioni i DRAP Fier.

III. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjek procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020.

DREJTORI



BRUNILDA DHAMO

